

Heqja e brirëve te viçat

*Dr. Michael Hulek, veteriner dhe ekspert i trajtimit të thundrave
në Austri dhe këshillues i QFPB*

Përkthyer dhe përpunuar nga Olger Nanagjoka



Për të hequr brirët te viçat duhet që vicat të kalojnë në narkozë dhe duhet të marrin mjekimin dhe qetësuesit përkatës.

I. Pyetje dhe përgjigje:

1. Në cilën moshë mund t'u hiqen brirët viçave?

Heqja e brirëve bëhet në periudhën ndërmjet javës së 2-të dhe të 6-të pas lindjes. Që në javën e dytë sythi i bririt fillon të bëhet i prekshëm dhe i dukshëm. Veterineri i injekton Xylazin, qetësues për dhimbjet. Tek viçat më të mëdhenj se 6 javë duhet bërë patjeter anestezi e përgjithshme ose ajo lokale nga veterineri.

Viçat duhet të jenë të shëndetshëm dhe duhet të mësohen me mjedisin përreth dhe me grupin.

Ju lutem konsultohuni me veterinerin mbi rregullat e kujdesit të kafshëve në vendin tuaj.

2. Përse duhet të jepet bashkë me qetësuesin edhe një preparat kundër dhimbjeve?

Xylazina është një qetësues që i injektohet kafshës në mënyrë që të qëndroje e palëvizur gjatë procedurës dhe efekti i preparatit kundër dhimbjeve zgjat vetëm për një kohë të shkurtër. Kundër dhimbjes afatgjatë nga heqja e brirëve, e cila manifestohet nëpërmjet rritjes së frymëmarrjes, dridhjes së veshëve, kruarjes së kokës, lëvizjes në mënyrë të vazhdueshme të bishtit, duhet të përdoret edhe një preparat josteroidal (NSAID) kundër infektimit të plagës. Viçat vuajnë më pak dhe konsumojnë më shumë ushqim.

Duhet të konsultoheni me veterinerin tuaj për mjekimin e duhur gjatë heqjes së brirëve.

3. Pse zona rreth sythit të bririt duhet pastruar nga qimet?

Duke pastruar ose hequr qimet, sythi i bririt bëhet i dukshëm edhe tek viçat 2 javësh. Përveç kësaj, qimet pengojnë procesin e djegies.

4. Pse maja e shufrës së nxehtë duhet të pastrohet sa më mirë për çdo heqje brirësh?

Vetëm me një shufër të pastër për djegie, garantohet shpërndarja e njëtrajtshme e nxehtësisë.

5. Përse mbas heqjes së brirëve duhet përdorur një spraj i posaçëm?

Duhet përdorur një spraj për të mbuluar dhe për të dezinfektuar zonën e trajtuar kundër papastërtive dhe mizave. I përhapur është përdorimi i një spraji blu me përmbajtje antibiotikësh. Për të reduktuar përdorimin e antibiotikëve, një alternativë e mirë do të ishte përdorimi i një spraji me jod ose alumin.

6. Pse viçat duhet të pozicionohen shtrirë me gjoks në tokë dhe duhen mbajtur në grupe të veçanta?

Pozicioni me gjoks shtrirë në tokë është mjaft i përshtatshëm për sistemin e qarkullimit të aparatit tretës të viçave, për të reduktuar rrezikun e gazrave në traktin e tretjes. Për të shmangur dëmtimet ose ndotjen nga viçat e semurë, viçat e shëndetshëm duhet të mbahen të ndarë dhe në kashtë të pastër.



Fig. 2: 10-15 minuta para procedurës viçave u injektohen qetësues.

II. Udhëzime për heqjen e brirëve

1. Përgatitja:

Programi fillestar:

- Të përgatitet lista e viçave të shëndetshëm, të moshës 2 deri në 6 javësh
- Të përcaktohet takim me veterinerin për të kaluar në anestezi viçat dhe të blihet qetësuesi nga farmacia veterinare.

Materialet:

- Shiringa dhe gjilpëra
- Qetësues kundra dhimbjeve (NSAID)
- Furnizimi me energji elektrike, zgjatues kablllo
- Gërshëre ose makinë rroje
- Shufër hekuri me kokë me djegie krejtësisht të pastruar
- Spraj blu, spraj alumini ose jodi



Fig. 3: Pas heqjes së qimeve, sythi i bririt është mjaft i dukshëm.



Fig. 4: Pas heqjes së bririt një spraj antibiotik vendoset për të parandaluar infeksionet.

2. Kryerja e procesit:

- ✓ Të bëhet injektimi i qetësuesve nga mjeku veteriner
- ✓ Të bëhet injektimi i menjëhershëm i anestetikëve
- ✓ Të pritët 10-15 minuta deri në dhënien e efektit të dëshiruar
- ✓ Heqja e qimeve me gërshërë rreth sythit të bririt
- ✓ Zgjedhja e madhësisë së kokës me djegie sipas asaj të sythit të bririt
- ✓ Fiksimi dhe rregullimi i kokës së viçit nga një person i dytë
- ✓ Të pritët derisa të arrihet temperatura maksimale e kokës me djegie

- ✓ Të vendoset kokës me djegie për 5-10 sekonda deri në formimin e një kanali 4-5 mm të thellë rreth sythit të birit. (Kujdes: Mbas 15 sekondash ekziston rreziku i dëmtimit të trurit!)
- ✓ Përdorimi i sprajit blu, sprajit të aluminit ose të jodit
- ✓ Vendosja e viçave të sapo dalë nga kjo procedurë në gjendje të palëvizshme dhe të ndarë nga të tjerët deri në rekuperimin e tyre